

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGIESI TE KUFIZUAR "LAVANDER" SHPK

Neni 1

Emri

Shoqëria " Lavander" sh.p.k , është një shoqëri me përgjigjësi të kufizuar e cila themelohet dhe vepron në bazë të legjislacionit Shqiptar. (Më poshtë e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërise ndodhet në Tiranë, Rruga Nikolla Tupe, Ndërtesa 2, ose në ndonjë qytet tjetër të Republikës së Shqipërisë në vëndin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Shoqëria mund të themelojë ose të mbyll filiale, degë apo përfaqësi të saj në qytete të tjera të Shqiperisë dhe jashtë saj të cilat do të krijohen në bazë të lëgjislacionit shqiptar dhe atë të vëndeve ku do të ngrihen.

Neni 3

Kohëzgjatja


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

Neni 4

Objekti

Shoqëria ka objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjigjesi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit Shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe cdo aktivitet tjetër që ka lidhje dhe ndihmon në realizmin e këtij aktiviteti, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Shërbime në fushën e pastrimit kimik, lavanderisë dhe mirëmbajtjes;
- b) Tregti me shumicë e pakicë e artikujve të ndryshëm;
- c) Punime artistike, qëndistari, rrobaqepsi, bizhuteri;
- d) Import - eksport i mallrave industriale, ushqimore;
- f) Transport mallrash dhe shërbimesh;



Neni 5
Kapitali Themeltar

Kapitali fillestari i shoqërise është 100.000 lekë, (njëqind mijë), kontribuar nga ortak i Vetëm i shoqërise, i ndarë në 1 kuote, vlera nominale është 100.000 lekë.
Znj. Arnida Çapi, shtetase Shqiptare, lindur në Berat më 15.02.1987, me nr identifikimi I75215073S është zotëruese 100% (njëqind për qind) të vlerës së kapitalit themeltar.

Neni 6
Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Adminstratori i saj. Znj. Arnida Çapi, shtetase Shqiptare, lindur në Berat më 15.02.1987, me nr identifikimi I75215073S, për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë riemërimi. Ortaku i Vetëm është organi vendimor i shoqërisë i cili ka gjithë kompenencat dhe fuqitë për të marrë vendimet përkatese në lidhje me ndryshimet në statut, shtimin apo pakësimin e kapitalit themelor, emërimin e administratorëve, të eksperëtive kontabel, zgjatjen ose pushimin e veprimtarive si dhe hapjen ose mbylljen e filialeve.

Organi administrativ i shoqërisë është Adminitratori, i cili zgjidhet nga Ortaku i Vetëm. Administratorit i jepen të gjitha kompetencat per administrimin e objektit te shoqërise me përjashtim të kompetencave të sipërpërmendua që statuti ja rezervon Ortakut të Vetëm. Pra Adminstratorit i takon përfaqësimi i shoqërise para të tretëve, në gjykatë, arbitrazhe, para administratës shtetërore e organeve të tjera.

Neni 7
Kushtet ekonomike

Orartku i vëtëm i shoqërisë përballon humbjen e saj vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributeve në kapitalin themeltar.

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtën e përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimit të që kryen.

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbriten amortizimi i të gjithë pasurive të luajtshme e të paluajtshme, sipas niveleve të miratuara, pagat, shtesat mbi pagë dhe shpenzimet e tjera që lidhen me to, shpenzimet për lëndët e para apo ndihmese, energjinë dhe shpenzime të përgjithshme të reparteve të shoqërisë, ato prodhuese e jo prodhuese, humbjet e vitit të mëparshëm, cdo shpenzim i lejuar dhe taksa mbi fitimin, merret nga Ortaku i Vetëm i shoqërise.



Shoqëria gjithashtu nga fitimi i realizuar gjatë vitit finansiar, lë mënjanë një shumë me vlerë të paktën 1\20 e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë deri sa ky fond të arrijë 1\10 e kapitalit themeltar.

Veprimtaria do të zhvillohet në bazë të parimeve ekonomike dhe do të pasqyrohet periodikisht në bilancet dhe llogaritë vjetore përkatëse sipas legjislacionit të kontabilitetit në fuqi.

Neni 8
Trashgimënia e trasferimi

Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm me rrugë trashgimine. Ai gjithashtu është lirisht i trasferueshëm tek persona të tretë me vendim të Ortakut të vetëm.

Neni 9
Likuidimi

Aktiviteti i shoqërisë mund të pushojë në rastin e parashikuar në satut ose në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Shoqëria mund të mbyllët në formën e riorganizimit ose të likujdimit. Në rastin e likujdimit, Ortaku i Vetëm emeron një likujdator tjetër i cili verpon në bazë të dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

Neni 10
Referime në ligj

Përsa nuk është parashikuar në statut dhe aktin e themelimit, i referohet ligjit përkatës në fuqi.

Hartuar në katër kijke, më Datë 01.12.2021

ORTAKU I VETEM
ARNIDA ÇAPI

Arnida Capi
Muratcapo